

Siguria online e fëmijëve dhe edukimi mediatik zgjasin për gjithë jetën

Linda Pino

Fëmijët dhe adoleshentët sot gjithnjë e më tepër janë duke përdorur internetin për të marrë informacion, argëtuar, komunikuar me shokë etj. Shqipëria është një vend që ka përqafuar teknologjinë prej vitesh. Pandemia e krijuar nga COVID-19, solli një tablo ndryshe nga vitet e tjera. 9 Mars 2020 shënoi ditën kur mbi 500 mijë fëmijë dhe adoleshentë në vend u “detyruan” të përdornin teknologjinë digjitale dhe internetin si mjetin e vetëm për të komunikuar, mësuar në distancë, argëtuar dhe për të marrë informacion. Sipas INSTAT, rreth 82.2 % e popullsisë në Shqipëri kanë akses të plotë në internet, gjë kjo që e kthen përdorimin e internetit dhe mbrojtjen prej tij në një prej situatave më të pakontrolluara dhe më të rrezikshme në vend.

Edhe pse Shqipëria ka ratifikuar një sërë marrëveshjesh dhe konventash ndërkombëtare që sigurojnë të drejtat e fëmijëve dhe mbrojnë interesin më të lartë të tyre, vendi ynë ende mangësi në drejtim të mekanizmave të mbrojtjes së fëmijëve gjatë lundrimit të tyre online, trajnimit të ligj-zbatuesve për metodat më të fundit të denoncimit dhe sigurisë online të fëmijëve dhe informimit të vazhdueshëm të shoqërisë për ta bërë internetin sa më të sigurt për fëmijët.

Ndërsa në vitet e fundit është vënë re një rritje e përdorimit të internetit në vend, përmirësimi i legjislacionit për të mbrojtur fëmijët online nuk ka ecur me të njëjtin ritëm. Mbrojtja kryesore që i ofrohet sot fëmijëve vjen nëpërmjet normave të Kodit Penal, ndonëse edhe ato janë të pjesshme dhe nuk ofrojnë një mbrojtje të qartë dhe të plotë të fëmijëve në internet.

Ky shkrim rreth sigurisë online të fëmijëve dhe edukimit mediatik i drejtohet prindërve dhe fëmijëve duke i pajisur me informacione që i ndihmojnë ata të përdorin me zgjuarsiri dhe në mënyrë të shëndetshme internetin.

A besoni gjithçka që lexoni ose shihni në internet?

Jo sigurisht që jo, dhe sot gjithnjë e më tepër lind e nevojshme që si prindër t’u mësoni fëmijëve që informacionet e ndryshme që marrin në internet jo gjithnjë janë të vërteta. Teknologjia po ndryshon vazhdimisht dhe fëmijët kanë qasje në shumë lloje të mediave ndërvepruese. Vetëm sepse fëmija juaj mund të kuptojë teknologjinë, nuk do të thotë se ata i kuptojnë të gjitha ato që shohin, dëgjojnë ose ndajnë gjatë përdorimit të saj. Ata kanë nevojë për ju që t’i ndihmoni ata të zhvillojnë aftësitë digjitale ashtu sikundër i keni ndihmuar ata të mësojnë të ecin, të lexojnë dhe të shkruajnë.

Si prindër duhet të dini që përdorimi me intensitet të lartë i internetit apo dhe i medias sociale i ekspozon të fëmijët ndaj disa sjelljeve si: cyberbulling, sexting, ekspozimi ndaj përmbajtjeve të papërshtatshme, privatësia, diskriminimi, varësia nga interneti etj. Edukimi mediatik dhe informimi është i rëndësishëm edhe për ju prindër, pasi më parë se ju t’u mësoni fëmijëve se si të lundrojnë të sigurt në internet apo dhe të dallojnë mes informacioneve të sakta dhe ato fake, lind e nevojshme që edhe ju të dini përkufizimin e një sërë terminologjish.

Cyberbullying është terminologji që përdoret kur njerëzit përdorin internetin për të kërcënuar, ngacmuar, apo poshtëruar dikë duke dërguar mesazhe, fotografi dhe video.

Grooming është përgatitja dhe manipulimi psikologjik që i bëhet një fëmije me qëllim shfrytëzimin seksual.

Sexting është dërgimi i mesazheve me natyrë seksuale apo erotike fëmijëve kryesisht nëpërmjet celularëve.

Pedofilia i referohet njerëzve që kanë interes seksual ndaj fëmijëve, për t'i abuzuar ata seksualisht në Internet apo në jetën reale.

Përmbajtje e papërshtatshme është një përkufizim i cili i referohet çdo lloj përmbajtje në internet, verbale, vizuale, audio dhe video i cila është e rrezikshme dhe e papërshtatshme për moshën e fëmijëve por është në dispozicion të publikut.

Varësia nga Interneti është përdorimi i tepruar i internetit deri në masën sa ndërhyr në aktivitetet e jetës së përditshme. Nga pikëpamja e sjelljes mund të konsiderohet si një sjellje kompulsive dhe përkufizohet klinikisht si një sjellje e cila bëhet jo sepse është e këndshme dhe e dobishme por për shkak se individi mendon se duhet ta bëjë.

Më poshtë do t'ju japim disa këshilla që ju si prindër mund të ndiqni për ta bërë internetin më të sigurt për fëmijët tuaj.

- **Lundroni në internet së bashku me fëmijën tuaj:** Prindi duhet të jetë personi kryesor që udhëzon fëmijën për mënyrën se si duhet ta përdorin interneti. Kjo do të ndikojë mjaft pozitivisht në ndarjen mes njëri-tjetrit të eksperiencave pozitive si edhe ato negative të ndeshura online.
- **Kushtojini vëmendje:** Uluni dhe ju afër kompjuterit me fëmijën tuaj dhe bisedoni rreth asaj se çfarë është duke bërë, interesin që shfaq.
- **Lexoni më shumë në lidhje me atë çfarë po shikon fëmija juaj në ekranin e kompjuterit/tabletit ose telefonit:** Kjo nuk do të thotë që ju jeni duke kontrolluar gjithçka që bën fëmija juaj, por gjithsesi të informoheni rreth faqes së internetit që po shikonte fëmija juaj. Kjo do ta mbrojë atë nga ndodhi të pakëndshme.
- **Përdor mekanizmat teknologjisë për internet të sigurt:** Filtrat e internetit, software dhe udhëzuesit mund ti kërkon pranë subjekteve në të cilat ju blini kompjuterët do t'ua lehtësojnë monitorimin e aktivitetit të fëmijës tuaj online.
- **Tregohuni të vëmendshëm ndaj sinjaleve paralajmëruese:** Një fëmijë që heziton të flasë me familjarët në lidhje me aktivitetin e tij online ose që duket i tërhequr nga familja dhe miqtë mund të ketë një problem. Ndryshimi i personalitetit të fëmijës tuaj mund të jetë një shenje se diçka po ndodh me fëmijën tuaj dhe ekspozimi ndaj pornografisë dhe cyberbullying mund të jetë një shkak i këtyre ndryshimeve.
- **Mësoni t'u thoni fëmijëve dhe jo:** Nëse fëmija juaj vazhdimisht kalon shumë kohë në internet ose shpërfill rregullat në lidhje me përdorimin e kompjuterit është koha që

të merrni masa deri në shkëputjen e lidhjes së internetit. Sigurohuni që të jeni të qartë që të argumentoni këtë vendim si dhe për kohëzgjatjen e vendimit.

Seksioni më poshtë ju drejtohet fëmijëve dhe adoleshentëve që sot gjithnjë e më tepër janë kthyer në përdoruesit kryesorë të internetit. Përpos lehtësirave dhe avantazheve që Interneti ofron, duhet të keni parasysh që janë miliona njerëz që përdorin internetin, atëherë edhe numri i keqpërdoruesve është i madh. Edhe pse ka rreziqe në internet, fëmijët nuk mund të kufizohen nga përdorimi i internetit, sepse në ditët e sotme përdorimi i internetit është një pjesë natyrore e zhvillimit të fëmijëve.

Disa nga rreziqet me të cilat ju si fëmijë do të ndesheni më tepër janë:

Përmbajtja e paligjshme dhe e papërshtatshme

Jo të gjitha përmbajtjet që janë në internet janë të përshtatshme për të gjitha moshat. Disa nuk rekomandohen të shikohen nga fëmijët e moshave nën 18 vjeç. Në momentin që ju jeni duke u ndeshur me këto përmbajtje duhet të keni parasysh:

- Respektoni kufizimet e moshës suaj, jo çdo përmbajtje apo informacion që ju merrni janë të përshtatshme për çdo moshë.
- Asnjëherë mos jepni të dhënat tuaja personale dhe menjëherë diskutoni me prindërit për këtë ndodhi të pakëndshme.
- Mos shkarkoni dhe dërgoni foto dhe video me përmbajtje të papërshtatshme; § Vizitoni faqen www.isigurt.al-Platforma për Mbrojtjen e Fëmijëve Online, për të raportuar rastet konkrete dhe për t'iu informuar për mënyrat se si mund ta mbrojnë veten gjatë përdorimit të internetit; § Kontaktoni Linjën Kombëtare të Këshillimit për Fëmijë ALO 116 111.

E keni hasur ndonjëherë terminologjinë e "Cyberbullying"?

Ju duhet të dini që cyberbullying ndodh kur një fëmijë apo adoleshent është kërcënuar, keqtrajtuar, poshtëruar, tallur, ofenduar ose është vënë në shënjestër në mënyrë të qëllimshme nga një fëmijë ose adoleshent tjetër duke shfrytëzuar përdorimin e internetit, teknologjitë ndërvepruese dhe digjitale ose telefonat celularë.

A e dini se çfarë mund të bëni?

Rregulli i parë: Mos iu përgjigj mesazheve cyberbullying, por ruajini ato bashkë me orën dhe datën që i keni marrë si dëshmi në rast raportimi. Rregulli i dytë: Bllokoni aksesin e atyre personave me të cilët nuk dëshironi të komunikoni. Bisedoni menjëherë me prindërit apo një të rrituri të besuar dhe së bashku përpiquni të identifikoni personin i cili ju ngacmon. Rregulli i tretë: Mos heshtni. Heshtja, kur të tjerët janë duke ju lënduar, nuk është e pranueshme. Nëse i lejoni në të vazhdojnë t'iu mendojnë, t'iu vënë në siklet cyberbullying nuk do të ndalet.

Lojërat Online

Nëse luani lojëra në internet, jeni të ekspozuar ndaj rreziqeve të ndryshme. Shpesh ka persona të rritur, që përfshihen në lojë bashkë ju. Ata shpesh herë mund të shtiren sikur janë fëmijë për të krijuar shoqëri, por qëllimi i tyre mund të mos jetë i mire pasi mund të duan të fitojnë besimin tuaj me qëllim që mund t'iu bëjnë keq më vonë. Në situatë të tilla ju sugjerojmë që të përdorni

pseudonime gjatë lojës, në mënyrë që të mos zbulohet identiteti juaj. Mos i ndani informacionet tuaja personale me njerëz të panjohur. Mbrojeni veten tuaj kur jeni duke luajtur, duke përdorur fjalëkalime (password) të forta. Pyesni prindërit tuaj për lojën të cilën dëshironi të luani, pasi prindërit kanë mundësi t'u monitorojnë dhe ndihmojnë të zgjidhni lojëra të sigurta. Mos përdorni lojëra të pa licencuara (lojëra pirate).

Mbase dhe ju ka ndodhur, por gjatë lojës shpeshherë shfaqen (faqe interneti të cilat hapen vetë) në ekranin tuaj. Përgjithësisht janë reklama, por mund të ketë edhe faqe me përmbajtje të papërshtatshme. Hapja e tyre automatikisht rrezikon kompjuterin që po përdorni duke qenë se ato mund të jenë burim virusesh të cilat dëmtojnë gjendjen e tij.

Interneti vërtet që në ditët e sotme është bërë i domosdoshëm. Por **qëndrimi për një kohë të gjatë rrezikon t'ju krijojë varësi ndaj përdorimit të internetit**. Njohjet me njerëz të panjohur, faqe të ndryshme në internet dhe rrjetet sociale, dhomat e chat-it etj, ofrojnë mundësi të ndryshme krijimin e njohjeve të reja me miq të rinj virtual. Si rrjedhojë mund të takoni edhe njerëz, të cilët nuk kanë asnjë qëllim të mirë ndaj jush. Ata përgjithësisht janë të rritur të cilët fshihen pas profileve dhe identiteteve false. Informacioni që ata përcjellin për vetëm e tyre mund të jetë i trilluar. Duhet të tregoheni të kujdesshëm në rast se kërkojnë të ketë një takim nga afër me ju. Rekomandohet ta diskutoni më parë me prindërit tuaj.

Mos shkarkoni foto ose video të dërguara nga adresa/persona të panjohur ose të njohur nëpërmjet internet, nuk mund ta dini se si mund të përdoren ato prej tyre. Tregojuni menjëherë prindërve, familjarëve më të rritur, mësueses tuaj nëse ndiheni të rrezikuar ose të frikësuar. Mos lini takim dhe mos u takoni me asnjë person me të cilin jeni njohur nëpërmjet internetit, asnjëherë nuk e dini se kush qëndron në anën tjetër të kompjuterit! Tregohuni të kujdesshëm!

Të gjithë fëmijët sot duhet të mësojnë se të jesh i sigurt ndërkohë që je duke lundruar në internet është e mundur, po vërtet që është e mundur. Në Shqipëri ka mekanizma kombëtare ku ju mund të kërkonte informacione se si të lundrojnë të sigurt online, apo dhe ku ata të mund të raportojnë.

Raporto pranë www.isigurt.al - Platforma për Mbrojtjen e Fëmijëve Online.

Telefononi ALO 116 111 - Linjën Kombëtare të Këshillimit për Fëmijë për të raportuar çdo shqetësimin tuaj.



Kjo rubrikë është prodhuar me ndihmën financiare të Bashkimit Europian. Përgjegjësia e vetme për përmbajtjen e këtij dokumenti është e Institutit Shqiptar të Medias dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet se reflekton pozicionin e Bashkimit Europian.



The regional program "Media for Citizens – Citizens for the media: Strengthening the Capacity of NGOs for the Development of Media and Information Literacy in the Western Balkans" is implemented with the support of the European Union by partner organizations Mediacentar Sarajevo, Albanian Media Institute, Macedonian Institute for Media, Montenegrin Media Institute, Novi Sad School of Journalism, Peace Institute, SEENPM.